



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

01 Numër:30/2022  
Data: 25 .03.2022



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>  
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/ SKUPŠTINAOPŠTINE/ MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

KRYESUESI I KUVENDIT

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Me kërkesë të 13 anëtarëve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për shkak të mos bllokimit të punës së Kuvendit duke u bazuar në nenin 44 paragrafi 44.1, 44.2, 44.3, 44.4 dhe 44.5 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisjen Lokale; nenin 51 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr. 62/2010; nenin 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL ) Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe nenin 8 paragrafi 1 , 2, 3 dhe 4 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Istogut Nr. 2/2013:

### T H Ë R R A S

Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **31.03.2022, ditën e enjte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora **10:00**.

### R E N D D I T E:

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
3. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
4. Themelimi i Komitetit për politikë e Financa,
5. Themelimi i Komitetit për Komunitete,
6. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB),
7. Formimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
8. Formimi i komisionit të aksionarëve për NK " Stacioni i Autobusëve në Istog " .
9. Themelimi i Komisionit të aksionarëve për KRM " Ambienti " njësia në Istog,
10. Formimi i komisionit për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik Edukativo – Arsimor dhe aftësisë para universitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.
11. Formimi i komisionit për ndarjen e bursave,
12. Formimi i komisionit për ankesa ndaj ndarjes së bursave,
13. Formimi i Grupit të Grave Asambleiste ,
14. Formimi i Komitetit për Barazi Gjinore,

15. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021,
16. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021,
17. Shqyrtimi dhe miratimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës me qëllim të zhvillimit ekonomik në aspektin: lokal, urban dhe bujqësor sipas Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022,
18. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

**Vërejtje :**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL.

**Kryesuesi i Kuvendit  
z. Enver Rugova**

